



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MAT
KRYETARI**

Nr. _____ Prot.

Burrel, më _____.____.2021

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË
SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Drejtuar: Operatorin Ekonomik: “NELSA” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **J71601012S**

Adresa: Tiranë, Dajt, DAJT, lagjja “Qesarak”, rruga Tiranë-Dajt, Zona kadastrale 2460, me nr.pasurie 199/32, Hyrja 1.

Procedura e prokurimit: “E Hapur e Thjeshtuar - Mallra” – Marrëveshje Kuadër – me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj.

Numri i referencës së procedurës: **REF-98347-06-16-2021**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Loti Nr. 1: “Blerje Ushqime”, me fond limit për shumatoren e çmimeve për njësi në vlerën: **2 991** (dy mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e një) **lekë pa TVSH**. Vlera e pritshme e kontratave që mund të lidhen gjatë gjithë periudhës së marrëveshjes kuadër: **1 280 345** (një milion e dyqind e tetëdhjetë mijë e treqind e dyzet e pesë) **lekë pa TVSH**, ndarë për vitin 2021 në vlerën: **896 241** (tetëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e dyzet e një) **lekë pa TVSH**, nga granditë: 840 241 (tetëqind e dyzet mijë e dyqind e dyzet e një) lekë pa TVSH dhe nga të ardhurat: 56 000 (pesëdhjetë e gjashtë mijë) lekë pa TVSH, ndërsa për vitin 2022 në vlerën: **384 104** (treqind e tetëdhjetë e katër mijë e njëqind e katër) **lekë pa TVSH** nga granditë, me afat realizimi të marrëveshjes kuadër: **12** (dymbëdhjetë) **muaj**.

Publikime të mëparshme (nëse aplikohet): nuk ka patur Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 95,
datë 21 Qershor 2021

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë/ lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

1. Operatori Ekonomik: “NELSA” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **J71601012S**

Vlera e ofruar për totalin (shumatoren) e çmimeve për njësi: **2 882.5** (dy mijë e tetëqind e tetëdhjetë e dy pikë pesë) **lekë pa TVSH**.

Vlera e ofruar për sasinë e pritshme të kontratave që mund të lidhen gjatë gjithë periudhës së marrëveshjes kuadër: **1 277 800** (një milion e dyqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind) **lekë pa TVSH.**

2. Operatori Ekonomik: **“PROINFINIT” Sh.p.k.,** me numër Nipt-i: **L92204018G**

Vlera e ofruar për totalin (shumatoren) e çmimeve për njësi: **3 978** (tre mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë) **lekë pa TVSH.**

Vlera e ofruar për sasinë e pritshme të kontratave që mund të lidhen gjatë gjithë periudhës së marrëveshjes kuadër: **1 250 700** (një milion e dyqind e pesëdhjetë mijë e shtatëqind) **lekë pa TVSH.**

Janë s’kualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori Ekonomik: **“PROINFINIT” Sh.p.k.,** me numër Nipt-i: **L92204018G**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtëm:

❖ Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik, shoqëria **“PROINFINIT” Sh.p.k.,** për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Veçanta të Pranimit/ Kualifikimit, si më poshtë:

I. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 1 gërma “a”/ 1. Ofetuesi duhet të paraqesë:/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

➤ Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST nuk është plotësuar me të gjithë të dhënat që kërkohen në pjesët e tij.

II. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.2.3/ 2.2 Për kapacitetin ekonomik dhe financiar/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.2.3 Vërtetim lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e taksave për vitin 2020 për adresën ku operatori ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR.

➤ Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2020 nga Bashkia Fier, dhe Lushnjë, duke qënë se sipas të

dhënave të marra nga Ekstrakti Historik i Regjistrimit shkarkuar nga faqja zyrtare e QKB-së (qkb.gov.al), rezulton se ushtron aktivitet që më datë 20.12.2019 në Bashkinë Fier, dhe që më datë 28.09.2020 në Bashkinë Lushnjë.

III. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.1/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të marrëveshjes kuadër.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,*
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

➤ **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur për vërtetimin e përvojës të mëparshme të realizuar me sektorin privat, konstatohet se Faturat tatimore shitje të paraqitura nuk janë të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi në të gjithë elementët e tyre.**

IV. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.3/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë “Pulari”, në pronësi ose në përdorim, ose me marrëveshje bashkëpunimi/ furnizimi sipas kontratës noteriale, e cila të tregojë qartë lidhjen e zyrtarizuar ndërmjet ofertuesit dhe prodhuesit. Në çdo rast, operatori ekonomik pjesëmarrës për “Pulari”, duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- *Çertifikatë Sanitare Veterinare;*
- *Liçencë lëshuar nga QKL: (Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore për një rrez (vezë); dhe Leje mjedisore – Për rritjen intensive të shpendëve.*

➤ **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk disponon “Pulari” në pronësi ose në përdorim, ose me marrëveshje bashkëpunimi/ furnizimi me prodhuesin i cili disponon pularinë.**

V. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.4/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë në pronësi ose në përdorim sipas kontratës noteriale ambjente të përshtatshme për magazinimin e mallrave të kërkuara si dhe me ambient frigoriferik e pajisur me leje Higjeno-sanitare, dhe çertifikatë DDD e vlefshme.

- Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se për ambientin e përshtatshëm për magazinimin e mallrave që ka në përdorim sipas kontratës noteriale nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar leje Higjeno-sanitare dhe çertifikatë DDD për këtë ambient.

VI. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.5/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qera, automjet të përshtatshëm ATP me qëllim transportin e mallit, të cilin duhet ta ketë në pronësi, huapërdorje ose me qira, dhe për të cilin duhet të paraqesë dokumentacionin përkatës, si më poshtë:

a) Dokument që vërteton pronësinë ose huapërdorjen ose qiramarrjen si më poshtë:

➤ Dokumentacioni që vërteton pronësinë:

- Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj; ose kontrata e shitblerjes; ose kontrata e dhurimit; ose çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

➤ Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen:

- Kontratë huaje.

➤ Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:

- Kontratë qiraje.

b) Leje qarkullimi e mjetit.

c) Çertifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore,

d) Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve,

e) Çertifikate për transport mallrash, për mjetet me kapacitet transportues mbi 1500 kg

- Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se kontrata e qirasë e nënshkruar nuk është noteriale, sipas formë së kërkuar në zbatim të legjislacionit në fuqi.

VII. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.7/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.7 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Raport Analize origjinale ose kopje të noterizuar, lëshuar nga një laborator i autorizuar i kontrollit ose i referencës, për produktet e ofruar, objekt prokurimi.

- Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk ka paraqitur Raport Analizat origjinale ose kopje të noterizuar për produktet e ofruar, objekt prokurimi.

VIII. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.8/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të operojë duke plotësuar standartet në fuqi për sigurinë ushqimore. Për këtë, ai duhet të paraqesë vetdeklarim, ku të deklarojë se nga kontrolli i fundit ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk ka paraqitur deklaratën me përmbajtjen e kërkuar në këtë pikë.**

* * *

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si të suksesshëm:

1. Operatorin Ekonomik: **“NELSA” Sh.p.k.**, me numër Nipt-i: **J71601012S**

Vlera e ofruar për totalin (shumatoren) e çmimeve për njësi: **2 882.5** (dy mijë e tetëqind e tetëdhjetë e dy pikë pesë) **lekë pa TVSH.**

Vlera e ofruar për sasinë e pritshme të kontratave që mund të lidhen gjatë gjithë periudhës së marrëveshjes kuadër: **1 277 800** (një milion e dyqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind) **lekë pa TVSH.**

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

Titullari i Autoritetit Kontraktor